

No. 2628 Prot

dt. 19.10.2021

*Zyres Jurimore  
Zyres se Informacionit*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 2337 Prot  
Nr. 2633 Rëgj

Tiranë, më datë 13.10.2021

**Lënda:** Njoftim për publikim në ankand të I të pasurisë së paluajtshme.

**Drejtuar:** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.  
Bashkia Delvinë.

Bashkëlidhur me këtë shkresë po ju dërgojmë, Vendimin date 13.10.2021 "Per shpallje ne ankand te parë për pasuritë e paluajtshme" në pronësi të palës debitore Musa Brahim i për vënien në zbatim të titullit ekzekutiv Urdhëri i Ekzekutimit Nr.40, datë 25.03.2009 i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Sarandë, leshuar kontratën e Kredisë Bankare nr.3189 Rep, Nr.1035 Kol, datë 18.05.2006.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Zyra Përmbartimore Private "Bailiff Services Albania" sh.p.k  
Përmbartues Gjyqësor Privat  
ERION LLALLA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



BSA

Bailiff Services Albania

Tiranë, më datë 13.10.2021

Nr. 2337-Prot  
Nr. 2633 Regj.

VENDIM

Për shpalljen në ankand të parë të pasurisë së paluajtshme

Drejtuar: Palëve

Pranë zyrës përbarimore private "Bailiff Services Albania" sh.p.k, me kerkesen kreditorit është vënë në ekzekutim Urdhëri i Ekzekutimit Nr.40, datë 25.03.2009 i Gjykates së Rrethit Gjyqësor Sarandë, leshuar kontratën e Kredisë Bankare nr.3189 Rep, Nr.1035 Kol, datë 18.05.2006, me pale:

- Kreditor: Banka Kombëtare Tregtare sh.a
- Debitor: MUSA BRAHIMI
- Dorëzues: VAZELINË BRAHIMI
- Objekti: Kthim Kredie

Në bazë të nenit 517 të K.Pr.Civile i është komunikuar pales debitore njoftimi për ekzekutim vullnetar. Me marrjen dijeni nga ana e palës debitore nuk është vepruar. Për rrjedhojë në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile ekzekutimi i titullit ka kaluar në ekzekutim të detyrueshëm, duke vendosur masën e sekuestros mbi pasurinë e paluajtshme të palës debitore.

Pasi është vendosur masa e sekuestros nga ana jonë i është dërguar njoftim palëve debitor dhe kreditor që brenda afatit ligjor prej 7 (shtatë) ditë të caktojne me mirëkuptim ndërmjet tyre çmimin e pasurisë së paluajtshme. Megjithëse afati ka kaluar pranë zyrës përbarimore nuk është depozituar asnjë marrëveshje për caktimin e çmimit të pasurisë së paluajtshme. Për rrjedhojë për vlerësimin e pasurisë së sekuestruar në përputhje me nenin 564 të K.Pr.Civile është caktuar eksperti i licensuar. Eksperti me akt ka bërë vlerësimin e pasurisë së paluajtshme të pales debitore. Në bazë të aktit të ekspertimit të paraqitur nga eksperti si dhe mbështetur në nenin 564 të K.Pr.Civile është caktuar çmimi i pasurisë së paluajtshme. Ky çmim i'u është komunikuar palëve në proces ekzekutimi së bashku me aktin e vlerësimit të pronës. Gjithashtu i është lënë afat palës debitore për të shlyer detyrimin por nga ana e saj nuk është vepruar, si dhe pranë zyrës përbarimore nuk është depozituar asnjë vendim gjyqësor për pezullimin e veprimtarisë përbarimore.

Mbështetur në akt ekspertizën e *ekspertit vlerësues z. Elena Gliozheni për vlerësimin e Pasurisë* Pasuri Nr.4/69, Zk. 1464 me sipërfaqe 255 m2 nga të cilat 98 m2 ndërtes me kodin Unik 1464006008 e llojët Truall+ Ndërtes me adresë Delvinë., është vlersuar me vlerën prej 4,400,000 (katërmiljon e katërqind mijë) lekë.

Në këto kushte në bazë të nenit 555 e vijues të K.Pr.civile duhet të caktohet një çmim me 80% të vlerës të caktuare nga eksperti.

Në bazë të nenit 568 e vijues të K.Pr.Civile si dhe Ligjit Nr 26/2019 Për Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Privat

## VENDOSA

1-Të shpall ankandin e I (parë) për shitjen e pasurive së paluajtshme të cilat përbëhen nga:

- Pasuri Nr.4/69, Zk. 1464 me sipërfaqe 255 m2 nga të cilat 98 m2 ndërtes me kodin Unik 1464006008 e llojët Truall+ Ndërtes me adresë Delvinë në shumën 3 520 000 (tremiljon e pesqind e njëzetëmijë ) lekë.
- 2- Secili ofertues duhet të depozitojë si garanci në llogarinë e Zyrës Përmbartimore "Bailiff Services Albania" sh.p.k. me nr. NIPT L02127004B shumën prej 10% të çmimit fillestar, në numrin e llogarisë pranë "Alpha Bank" sh.a në numrin e llogarisë IBAN AL 3490 2116 6343 9123 0014 786 052, në lekë.
- 3- Ankandi do të qëndrojë i publikuar nga data 13.10.2021 deri në datë 28.10.2021 dhe zhvillohet në këtë datë ora 15:30 pranë Zyrrave Përmbartimore Private "Bailiff Services Albania" sh.p.k.
- 4- Publikimi i këtij ankandi kryhet konform nenit 568 të K.Pr.Civile.
- 5- Ky vendim i komunikohet palëve, të cilët kundër tij kanë të drejtën e ankimit brenda 5 ditëve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.

Zyra Përmbartimore Private "Bailiff Services Albania" sh.p.k  
Përmbartues Gjyqësor Privat  
ERION LLALLA

